

TREPÇAS MINE IN STAN TERG DURING THE 20th CENTURY

THE TOPIC FOR TITLE

Science Doctor of History contemporary

By Mustafë Haziri



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

**THE UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”
FILOSOPHY OF FACULTY**

THE HISTORY

Prishtina, January 2017

TREPÇAS MINE IN STAN TERG DURING THE 20th CENTURY

Topic presented

By Mustafë Haziri

Of

History department

In order to get the title

The Doctor of contemporary History



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Filosofy Faculty

Prishtina

Accepted by:

Prof. Dr. Asoc. Bujar Dugolli – Mentor

Prof. Dr. Asoc. Muhameg Mala- Member

Dr.sc. Sabile Keçmezi-Bala- Member

Prof. Dr. Ibrahim Gashi- Member.

January 2017

REZYME

Në këtë disertacion të doktoratës kam arritur që në mënyrë kronologjike dhe të detajuar ti paraqes disa aspekte të rëndësishme historike për Minierën e Trepçës në Stanterg duke elaboruar nga periudha iliro-romake, dhe koha e Mesjetës duke vazhduar deri në kohën e re, por duke u fokusuar kryesisht në periudhën e historisë bashkëkohore gjegjësisht në shekullin XX, ku zhvillimet në Trepçë ishin të rëndësishme si në aspektin historik ashtu edhe në atë ekonomik- politik dhe social.

Duke i bërë një analizë shkencore burimeve arkivore, dhe duke u bazuar në referencat akademike dhe publicistike, mund të konkludojmë se rëndësia historike e Minierës së Trepçës në Stan-Tërg, ishte e madhe si në aspektin ekonomik e politik, ashtu edhe atë historik dhe social, duke filluar nga periudhat e hershme të historisë e deri në ditët e sotme e me theks të veçantë në shekullin e XX.

Në fillim të shekullit të XX-të, filluan hulumtimet e para të anglezëve në këtë minierë. Këto hulumtime filluan në vitin 1926, kurse eksploatimi modern i Trepçës filloi në vitet e 30'ta të këtij shekulli, i cili u përcoll me lëvizje sindikale si para ashtu edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Blerja e minierës së Trepçës me koncesion e anglezëve nga Mbretëria SKS, ndikoi në rivitalizimin e saj, pasi që Mbretëria jugosllave nuk kishte mundësi investuese.

Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, raportet ndërkombëtare ndryshuan dhe në vitin 1941, Miniera e Trepçës ra në duart e Gjermanisë fashiste, deri në vitin 1944, ku e me përfundimin e luftës, kemi një rikthim të anglezëve deri në vitin 1948, ku me nacionalizimin e pronave në Jugosllavi "Trepça" kaloi në pronë shtetërore, kurse shteti jugosllav si kompensim i ndau anglezëve 4.5 milion funta.

Sipas dokumenteve të Agjencionit shtetëror të Arkivit të Kosovës deri në vitin 1974, shteti jugosllav nuk kishte ndonjë strategji të veçantë për zhvillimin e Minierës së Trepçës, por megjithatë gjatë viteve 1979-80, kjo minierë i mbulonte nevojat e veta financiare nga kreditë bankare. Nacionalizimi serb, i cili mendohej se ishte frenuar pas Luftës së Dytë Botërore, në fakt ai ishte kanalizuar brenda sistemit jugosllav.

Kjo u vërejt në Grevën e Minatorëve të Trepçës në shkurt të vitit 1989, ku minatorët dolën në mbrojtje të Kushtetutës së Kosovës. Greva pati karakter politik dhe social, i cili vuri në pah dobësitë e organizimit të brendshëm të sistemit jugosllav.

Këtu shihet karakteri jo vetëm politik, por edhe nacional i Grevës së Minatorëve të Trepçës në Stanterg, sepse minatorët ishin të vendosur që t'i mbronin të drejtat kombëtare, ndaj ata ishin të vetëdijshëm se duhet të ndërpritet politika e gabuar ndaj popullit shqiptar në Kosovë.

Greva e Minatorëve në Stanterg kishte rëndësi të madhe për vet faktin se në proceset e mëvonëshme politike në përgjithësi, por pa dashur t'i ekzagjeroj shkrimet e ndryshme.

Duhet të jemi të matur në vlerësimin se, siç thuhej, kjo grevë i tundi themelet e ish-Jugosllavise socialiste, por në këtë kontekst kemi arritur në përfundim se greva në fakt nuk kishte fuqinë e duhur t'i trondiste themelet e një shteti të fuqishëm ekonomikisht dhe ushtarakisht, por, ç'është e vërteta, kjo grevë, i vuri në spikamë dobësitë e organizimit të brendshëm politik të shtetit jugosllav dhe krejt në fund ndikoi që prestigji i këtij shteti brenda dhe jashtë u dobësua dhe u demaskua moralisht dhe politikisht.

Nuk duhet harruar se si lëvizjet e para kundër komunizmit mund të konsiderohet kryengritja legjendare në Hungari (1956), pastaj në Çekosllovakia pa harruar disidentin Vaslav Hawel, pastaj Levizjen "Solidarnos" të Leh Valences në Poloni dhe të gjithë ata intelektualë që kritikuan regjimin komunist në lindje, edhe tek ne me ngjarjet e vitit 1968 dhe 1981, të cilat ndikuan në zhvillimet e mëvonshme politike në Kosovë.

Megjithatë, duke u nisur nga perspektiva e atëherëshme politike nuk ka qenë e çuditshme të kërkohet që në emër të revolucionit për të cilën kishin derdhur gjak së bashku për Jugosllavinë socialiste e vetëqeverisëse të kombeve dhe kombësive të barabarta të kërkohet barazi kombëtare.

Duke shikuar në retrospektivën historike, jam munduar që të mos harrohet edhe "Apeli i 215 intelektualëve të Kosovës që u prezantua në opinionin Jugosllav, me 21 shkurt 1989, duke mos harruar rolin dhe rëndësinë e shtypit të kohës si atij të brendshëm ashtu edhe atij të jashtëm, në sensibilizimin e çështjes së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Me shembjen e regjimit komunist në ish - Jugosllavi u krijuan parakushtet për lirinë e popujve të këtij vendi edhe pse përfundimi, krizën jugosllave nuk e kishte kuptuar si problem serioz deri në vitet '90 të shekullit XX.

Këto ngjarje ndikuan në zhvillimet e mëvonshme politike në Kosovë, që determinuan krijimin e shteti të pavarur të Kosovës, ku miniera e "Trepçës" akoma edhe sot e asaj dite është aseti më i rëndësishëm ekonomik në vend.

Prishtinë, 2017